

*Shenime mbi pasqyrat financiare*

*“Harmonia” shpk  
(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)*

---

*Shenime mbi pasqyrat financiare*

*“Harmonia” shpk  
(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)*

25 QERSHOR 2020

## Shenime mbi pasqyrat financiare

**“Harmonia” shpk**  
**(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)**

---

### 1. Informacion i përgjithshëm.

Shoqëria “Harmonia” shpk është themeluar date 14.06.1995, regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, me nipt J62903480D.

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, nga statuti dhe Legjislacioni ne fuqi.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë “Harmonia” shpk është: Ndertim, zbatim te kategorive te specializuara te punimeve te ndryshme te ndertimit,punime dheu,sistemime taracash,ndertime civile,ndertime vepra arti,rikontruksion godinash.

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë është z. Stavri Prifti Selia e Shoqërisë është në Lagjja Kastriot,Rruga Leon Rei,Pallati Harmonia.

### 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

#### 2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar (SKK) dhe ligjin Nr. 25/2018, date 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

#### 2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

#### 2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

#### 2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Leke, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

#### 2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që

The image shows two handwritten signatures in blue ink. The signature on the left is more stylized and cursive, while the one on the right is more legible. Between the two signatures is a circular stamp, which appears to be an official seal or logo, though the details are not clearly visible.

## Shenime mbi pasqyrat financiare

**“Harmonia” shpk**

**(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)**

kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

### 2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

### 2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

### 2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

## 1. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### 1.1 Transaksionet në monedhë të huaj.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së



## Shenime mbi pasqyrat financiare

**“Harmonia” shpk**  
(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
Euro/LEK	121.77	123.42
USD/LEK	108.64	107.82

### 1.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

- Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionet për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

- Llogari të pagueshme



## Shenime mbi pasqyrat financiare

**"Harmonia" shpk**  
**(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)**

---

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

- Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.


Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 1.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.



## Shenime mbi pasqyrat financiare

**“Harmonia” shpk**  
**(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)**

### 1.4 Aktive afatgjata materiale i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

#### iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Makineri e pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Paj, zyre e informat	Vlera e mbetur	20%

#### iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata

## Shenime mbi pasqyrat financiare

**"Harmonia" shpk**  
**(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)**

---

materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

### 3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

### 3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

### 3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

### 3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.


### 3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshem (apo të rikuperueshem) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e



## **Shenime mbi pasqyrat financiare**

**“Harmonia” shpk**  
**(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)**

---

përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

### **3.10 Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

### **3.11 Transaksionet me palët e lidhura**


Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

### **3.12 Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

### **3.13 Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.





## Shenime mbi pasqyrat financiare

**"Harmonia" shpk**  
(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

---

### AKTIVET AFATSHKURTRA

**Aktive monetare** për 440.191 lekë, perfaqesojne mjete monetare ne:

- Banke 440.191 leke,
- Arke 0 leke.

Shoqëria operon me disa banka, te gjitha veprimet jane rregjistruar ne ditaret perkates, me llogarite ne valute veprimet jane kryer me kursin ditor te bankes, ndersa gjendja e monedhave te huaja ne fund te ushtrimit eshte vleresuar me kursin e Bankes se Shqiperise me date 31.12.2019 duke kaluar sipas rastit ne llogarite e shpenzimeve apo te ardhurave diferencat e kembimit.

**Te drejta te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit** në vlerën 303.019.680 leke perfaqeson llogarine Kliente 50.194.844 per vleren e faturave te paarketuara dhe vleften e apartamenteve te perfunduuar te pashitura ne Shumen 252.824.836 Keto llogari jane te analizuara sipas klienteve dhe rakordon me llogarine sintetike te tyre.

**Te tjera te drejta te arketueshme** ne shumen 47.489.064 leke paraqesin borxhin qe ortaku ndaj kompanise

Ne llogarite **Inventariale** shoqëria ka paraqitur gjendjen e mallrave ne shumen 204.246 leke. Vleresimi i tyre ne fund te ushtrimit eshte bere me kosto faktike.

### Aktivet afatgjata materiale

Shoqëria ka një vlerë neto aktivesh afatgjata materiale ne shumen 11.747.046 lekë, Ndertime 4.002.484 leke, makineri pajisje ne shumen 2.662.160 lek, mjete transporti ne shumen 5.062.480 lek dhe pajisje informatike ne shumen 19.922 lek Aam jane pakesuar per amortizimin e llogaritur ne shumen 2.146.797 leke.

### DETYRIMET DHE KAPITALI

**Kapitalet e veta** paraqiten me vlerë 110.547.904 leke.

**Kapitali i rregjistruar** i shoqërisë është 18.800.000 lekë, i perbere nga nje kuote e cila i perket ortakut te vetem te shoqerise z. Stavri Prifti Kapitali i regjistruar gjate 2019 eshte zmadhuar nga fitimi i vitit 2018 ne shumen 966.050 leke shume e cila ka kaluar ne rezerva te tjera per investime **Fitimi i ushtrimit** sipas bilancit kontabël paraqitet ne shumen 3.215.318 lekë.

### Detyrimet

Detyrimet me vlerë 32.224.119 lekë përfaqësojnë:



## Shenime mbi pasqyrat financiare

**"Harmonia" shpk**  
(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

	<u>Viti 2019</u>	<u>Viti 2018</u>
detyrime ndaj institucione te kredise	2.447.280	
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezim	2.444.420	12.846.714
Te pagueshme ndaj punonjesve	26.007.647	21.953.219
Detyrime te tjera tatimore	1.324.772	225.027
<b>Totali</b>	<b>32.224.119</b>	<b>35.024.961</b>

### Detyrime ndaj institucioneve 2.447.280 lek paraqet nje kredi ne BKT

Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit per 2.444.420 leke paraqesin llogarine furnitore per vlerën e faturave të palikujduara.

Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore paraqitet detyrimi i shoqerise per paga 26.007.647 leke paraqet paga ne shumën 25.581.523 lek dhe kontribute 426.124 lek shlyer vitin 2.020.

Detyrime tatimore leke 1.324.772 lek paraqet tvsh nentor shuma 1.055.790 lek likujduar 2020,tatim mbi te ardhurat skuma 18.200 lek paguar ne 2020 dhe tatim mbi fitimi 2019 shuma 250.782 lek paguar ne vitin 2020.

Te tjera detyrime ne shumën 220.128.204 leke, arketime ne avance te klienteve te pallatit mbyllur me kontrta shitje ne vitin 2020.

### Verifikimi i llogarise Fitime Humbje

Shpenzimet dhe të ardhurat janë grupuar si më poshtë:

	<u>Viti 2019</u>	<u>Viti 2018</u>
<b>Te ardhura</b>		
Nga shitja e mallrave dhe sherbimeve	33.178.676	23.899.490
Te ardhura te tjera nga vepr. shfrytez	865.800	
Shtimi i gjendjes se produktit te gatshem		
<b>Totali i te ardhurave</b>	<b>34.044.476</b>	<b>23.899.490</b>
Pakesim i gjendjes se produktit te gatshem		
Materiale te konsumuara	16.790.826	14.952.650
<b>Kosto e punes</b>	<b>11.000.424</b>	<b>9.041.230</b>
Pagat e personelit	9.421.440	7.745.189
Shpenzimet per sigurime	1.578.984	1.296.041
Amortizimi dhe zhvleresimet	2.146.797	1.252.328
Shpenzime te tjera	765.206	1.761.210
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>30.703.253</b>	<b>27.007.418</b>
Te ardhura te tjera	575.182	4.302.532
Diferencat nga kembimi	36.578	47.739
<b>Shpeznime financiare</b>	<b>92.164</b>	
<b>Fitimi bruto</b>	<b>3.815.631</b>	<b>1.146.865</b>
<b>Tatim fitimi</b>	<b>572.345</b>	<b>180.815</b>
<b>Fitimi neto</b>	<b>3.215.318</b>	<b>966.050</b>



## Shenime mbi pasqyrat financiare

**"Harmonia" shpk**

(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

Shpenzimet jane 30.831.995 leke, ndersa te ardhurat 34.619.658 lekë. Rezultati neto që shoqëria ka realizuar nga veprimtaria e saj gjate ketij viti ushtrimor është fitim ne shumen 3.215.318 leke.

Te ardhurat e realizuara gjate ushtrimit perfaqesojne: te ardhura nga aktiviteti ne shumen 33.178.676 leke, te ardhura nga qeraja ne shume 865.800 leke, te ardhura nga zyra e punes shuma 575.182 lek

Shitjet jane rregjistruar korrekt ne librat e shitjeve dhe te ardhurat rakordojne me situaten tatimore.

Shpenzimet per 30.831.995 lekë, jane te justifikuara me dokumenta te rregullta fiskale. Më konkretisht shpenzimet sipas zërave janë si më poshtë:

**Shpenzime per materiale** ne shumen 16.790.826 lekë, ato janë përdorur për veprimtarinë kryesore të shoqërisë, këto shpenzime janë të justifikuara me dokumenta te rregullta tatimore.

**Personeli**, në këtë llogari janë pasqyruar shpenzimet për paga 9.421.440 lekë, sigurime shoqërore 1.578.984 lekë, listëpagesat janë përpiluar saktë dhe shpenzimet për paga e sigurime janë vendosur korrekt në këtë llogari. Nje permbledhese e pagave paraqitet:

MUAJI	paga bruto	PER SIGURIME	PRONARI	I PUNESUARI	SIG SHENDET.	tatim mbi te ardhurat	nr punesuarve
JANAR	803.546	1.037.546	121.233	76.334	27.322	8.450	39
SHKURT	831.640	1.065.640	125.449	79.004	28.275	8.450	40
MARS	890.724	1.020.724	133.999	84.619	30.284	8.450	43
PRILL	915.544	915.544	137.332	86.977	31.128	8.450	33
MAJ	860.633	860.633	129.095	81.760	29.262	8.450	33
QERSHOR	900.544	900.544	135.082	85.552	30.618	8.450	32
KORRIK	759.360	759.360	113.906	72.141	25.821	8.450	31
GUSHT	627.000	627.000	94.050	59.565	21.318	8.450	21
SHTATOR	664.908	664.908	99.736	63.133	22.606	8.450	24
TETOR	663.818	663.818	99.573	63.063	22.570	9.100	22
NENTOR	772.542	772.542	115.542	73.392	26.266	9.100	27
DHJETOR	731.181	756.000	113.400	71.820	25.704	9.100	25
TOTALI	9.421.440	10.044.259	1.418.397	897.360	321.174	103.350	31

Amortizimi ne shumen 2.146.797 leke nuk kalon kufijte tatimor.

Shpenzime te tjera per 765.206 leke paraqesin:

Nr	Emërtimi i shpenzimit	Shuma në lekë	Dokumentet
1	trajtime	313.900	Fature tatimore
2	ekspert kontabel	180.000	Fature tatimore
3	sherbime noteriale	7.600	Fature tatimore
4	taksa	158.178	dok banke

## Shenime mbi pasqyrat financiare

**“Harmonia” shpk**  
(Per ushtrimin e mbyllur me date 31.12.2019)

5	komiison bankar	77.560	dok banke
6	gjoba	27.968	dok tatimesh
	<b>Totali</b>	<b>765.206</b>	

**Rezultati ushtrimor** neto që shoqëria ka realizuar nga veprimtaria e saj është fitim 3.215.318 leke.

### Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

### Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi supozimin e biznesit në vijimësi, dhe drejtimi mendon se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

**Administrator**

Stavri Prifti



**Hartuesi**

Florian Prifti